

***Dialog me Përfaqësues të Sektorit Privat***  
***Mbi ligjin nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”***

**Përshëndetje të gjithëve,**

Është kënaqësi të jem sot pjesë e kësaj tryeze të rëndësishme për të diskutuar mbi ligjin e ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe dëshiroj të falënderoj bashkëorganizatorët, Këshillin e Investimeve dhe Shoqatën Shqiptare të Investitorëve të Huaj (FIIA) për interesin dhe angazhimin e tyre në organizimin e këtij takimi.

Ligji i ri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i miratuar pas një periudhe të gjatë diskutimesh dhe konsultimesh me grupet e interesit, si edhe me asistencën e vyer të ekspertëve të Bashkimit Evropian, ka hyrë tashmë në fuqi në muajin shkurt të këtij viti. Ky ligj përbën një hap të rëndësishëm për përafrimin e kuadrit rregullator shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian dhe sjell risi thelbësore në mbrojtjen e të dhënave personale.

Do të ndalem shkurtimisht në disa nga risitë kryesorë të ligjit, veçanërisht ato që kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi bizneset si kontrollues dhe përpunues të të dhënave personale, pasi do të jetë Znj. Besa Velaj, Drejtore Kabineti, e cila do të bëjë më pas një prezantim më të zgjeruar mbi aspektet dhe ndryshimet e këtij ligji.

Në mënyrë të përmbledhur, ligji nr. 124/2024, sjell një sërë risish duke garantuar për qytetarët standardet më të larta në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, pasi:

- Zgjerohet kategoria e të drejtave të individit;
- Përmirësohen të drejtat që subjekti gëzon aktualisht me qëllim garantimin e një niveli kontrolli më të lartë mbi të dhënat e tij personale;
- Forcohet e drejta për akses;
- Rregullohet posaçërisht e drejta për të mos i’u nënshtruar vendimeve automatike; si edhe
- Rregullohet “e drejta për t’u harruar”, duke detyruar motorët e kërkimit të fshijnë me kërkesë të subjektit të të dhënave, informacionin në lidhje me të, i cili me kalimin e kohës nuk është më i nevojshëm.

Ndërsa për kontrolluesit dhe përpunuesit, lindin detyrime të reja, me qëllim garantimin më efektiv të sigurisë së informacionit në procesin e përpunimit të të dhënave personale. Nëse në ligjin e shfuqizuar detyrimet e kontrolluesit përcaktoheshin në një nen të vetëm, në këtë ligj që sapo ka hyrë në fuqi, këtij elementi i kushtohet një kapitull i tërë, ku trajtohen gjerësisht detyrimet dhe masat që një kontrollues duhet të ndërmarrë, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me detyrimet e ligjit dhe sigurinë e të dhënave.

Ndaj, në këtë kuadër, dëshiroj të theksoj se risitë e ligjit të ri, me të cilat do të njiheni më gjerësisht në vijim, na diktojnë drejt një fryme të re, drejt një qasje të re.

Jemi të vetëdijshëm se procesi i njohjes, kuptimit dhe ndërgjegjësimit në lidhje me ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale do të jetë sfidues, por edhe një proces në vazhdimësi dhe për këtë Zyra e Komisionerit mbetet e angazhuar për të lehtësuar dhe mbështetur sa më shumë qytetarët dhe ju si kontrollues e përpunues të të dhënave në zbatimin e detyrimeve të ligjit. Kjo, pasi është shumë e nevojshme që ligji të kuptohet dhe zbatohet në mënyrën e duhur nga të gjithë dhe për këtë do të keni të gjithë bashkëpunimin nga ana jonë, duke shpresuar dhe uruar në vendosjen e një partneriteti luajal institucional.

Në këtë kuadër, roli i oficerëve për mbrojtjen e të dhënave personale është kyç dhe këtu dua të theksoj se është pozitiv fakti që kemi pasur kërkesa për trajnime e për këtë arsye Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë do të realizojnë brenda këtij 6 mujori modulën e trajnimit apo kurrikulën për DPO-të, dokument ky i cili do t'u vijë në ndihmë këtyre nëpunësve me informacione orintuese mbi detyrat dhe përgjegjësitë e tyre si përgjegjës dhe garantorë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Ndërkohë, Zyra e Komisionerit bazuar në Rregulloren e Bashkimit Evropian GDPR ka hartuar draftin e metodologjisë për përlllogaritjen e sanksioneve administrative, si detyrim që rrjedh nga ligji nr. 124/2024, të cilën ju do të keni mundësi ta aksesoni në faqen zyrtare të Komisionerit dhe të jepni komentet tuaja përpara miratimit të saj.

Në gjithë këtë proces, roli juaj si përfaqësues të bizneseve është kyç, edhe në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit, si edhe dhënies së opinioneve për të arritur në produktin më të mirë të mundshëm. Ndaj e vlerësoj me shumë rëndësi organizimin e kësaj tryeze të përbashkët. Uroj që bashkëpunimi juaj me Zyrën e Komisionerit do të ndihmojë në garantimin e zbatimit të suksesshëm të ligjit dhe në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të besueshëm për të dhënat personale.

**Falënderit për vëmendjen!**